



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS ZUBIN POTOKUT

Numri i lëndës: 2023:182278

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05567105

P.nr.09/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Xhemajl JUSUFI, me zyrtaren ligjore Doruntina BEKA, në lëndën penale ndaj të pandehurit S.P. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale: Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.295/23 të datës 01.09.2023, duke vendosur sipas kërkesës për shqiptimin e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 12.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.295/23 të datës 01.09.2023, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP), jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

S.P., me pseudonim S., nga i ati N., nëna B., e gjinisë M., i lindur me datë ..., vendlindja Mitrovica, vendbanimi fshati Banje -Zubin Potok, me numër personal sipas letërnjoftimit të Serbisë, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, me profesion automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 25.02.2023 rreth orës 18:40 minuta, në fshatin Banjë Zubin Potok, me dashje kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës, përveç në kufirin apo vendkalimin e autorizuar kufitar, në atë mënyrë që njësia NJNSH gjatë patrullimit me dron pasi kanë vërejtur persona të dyshimtë në pyll dhe pasi kanë dal në pjesën e pyllit kanë ndaluar të pandehurin, dhe gjatë verifikimit vërtetohet se i njëjti kishte hyrë ilegalisht nga territori i Republikës së Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Me këtë ka kryer veprën penale Kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 140 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 dhe 140 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449, 450, 452, 493 dhe 495 të KPP-së e:

G J Y K O N

- I. DËNIM ME GJOBË në shumë prej 250 euro (*me fjalë: dyqind e pesëdhjetë euro*), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjukata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë të papaguar.
- II. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale, dhe atë në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 10 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.295/23 të datës 01.09.2023, kundër të pandehurit S.P., për shkak të veprës penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së dhe njëherësh, nga Gjukata ka kërkuar dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjukata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPP-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën akuzohet i pandehuri ligjvënësi ka parashikuar dënimin me gjobë me dyqind e pesëdhjetë (250) euro ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Gjukata vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë fajësinë e të pandehurit se e ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, dhe atë: raporti fillestar i incidentit i datës 25.02.2023, raporti i oficerit i datës 25.02.2023, procesverbali i marrjes në pyetje të të pandehurit S.P., të datës 27.02.2023, të dhënë në hetuesi,

informacionet e personit, fotoalbumi, informatat rreth kërkimit të personave nga Sistemi për menaxhimin e kufirit të datës 28.02.2023, si dhe shkresat përcjellëse të lendes janë prova të besueshme të cilat vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elemente të veprën penale Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare nga neni 140 paragrafi 1 të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhër ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, u bazua në nenin 140 paragrafi 1 të KPRK-së e cila dispozitë përcakton se: *“1. Kushdo që kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës në cilindo vend përveç në kufirin apo vendkalimet e autorizuara kufitare, dënohet me dyqind e pesëdhjetë (250) Euro gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.”*, ndërsa pas vlerësimit të të gjitha rrethanave për matjen e dënimit, Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, duke vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 38 të KPRK-së, pasi që një nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, duke vlerësuar se i akuzuari do të përmbahet nga veprime të paligjshme.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Sipas aktakuzës palë të dëmtuar nuk pati.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA ZUBIN POTOK
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.09/2023, datë 12.04.2024

Gjyqtari

Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala ka të drejtë kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) ditëve, nga dita e pranimit. Kundërshtimi i parashtrohet kësaj Gjykate